

## SHTYLLA II ÇËSHITJE PRAKTIKE ADMINISTRATIVE

*E drejta e ankimit kundër vendimit që refuzon kërkesën për masën e sigurimit të padisë*

*Nga Av. Suela Hasani*

### I. ABSTRAKT

Ky artikull trajton të drejtën e ankimit kundër vendimit që refuzon masën e sigurimit të padisë në procesin civil. Në paragrafin e parë përshkruhet kuptimi i masës së sigurimit të padisë dhe kushtet thelbësore për t'a kërkuar atë në gjykatë. Paragrafi i dytë trajton në mënyrë specifike procedurën e ankimit të masës së sigurimit të padisë dhe veçanërisht problematikën e ankimit të vendimit gjyqësor që refuzon marrjen e masës së sigurimit të padisë. Në paragrafin e fundit paraqiten përfundimet dhe rekomandimet e autorit për ndryshimet e nevojshme ligjore.

**FJALËT KYÇE:** *Masa e sigurimit; Fumus Boni Iuris; Periculum in Mora; Vendim i Ndërmjetëm*

### SHKURTIMET:

**Ligji nr. 49/2012**

“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. “Synimi i kësaj nisme ligjore ishte reformimi i procedurave gjyqësore të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve administrative në drejtim të shpejtësisë dhe cilësisë përmes ngritjes së një sistemi gjyqësor autonom të specializuar me gjyqtarë administrativë”

**KPC**

Kodi i Procedurës Civile

**KPCI**

Kodi i Procedurës Civile Italiane

### II. MASA E SIGURIMIT TË PADISË NË PROCESIN CIVIL

Masa e sigurimit të padisë në procesin civil është instrumenti ligjor i cili synon të ruajë gjendjen aktuale (*status quo*) deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes me vendim të formës së prerë, në mënyrë që të shmangë dëmin që mund t'i shkaktohet të drejtave të paditësit nga bërja e pamundur ose e vështirë e ekzekutimit të vendimit përfundimtar të gjykatës. Masa e sigurimit është një kërkesë urgjente e palës, e lidhur ngushtë me padinë e themelit dhe me karakter të përkohshëm. Qëllimi i masës së sigurisë së padisë nuk është zgjidhja e gjykimin të themelit por moscënimi i objektit të gjykimin.

Masa e sigurimit të padisë rregullohet nga nenet 202 - 212 të Kodit të Procedurës Civile. Neni 202 i KPC-së parashikon shprehimisht se: “Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë lejohet kur: a) padia mbështetet në prova me shkrësë; b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni.” Në interpretim të këtij neni dalin në pah kushtet thelbësore, në të cilat mbështetet gjykata për pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

Së pari, gjykata mund të vendosë masën e sigurimit të padisë vetëm nëse ka një kërkesë të tillë nga paditësi, kjo do të thotë se gjykata në asnjë rast nuk mund të marrë masa për sigurimin e padisë kryesisht.<sup>1</sup> Së dyti, parashikohen dy kushtet në të cilat mbështetet gjykata për pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë të cilat janë, ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë (*Fumus boni juris*) dhe kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë (*Periculum in mora*).

Përsa i përket kushtit të parë, *Fumus boni juris*, për pranimin e kërkesës së masës së sigurisë, gjykata duhet të vërtetojë minimalisht se ekziston një e drejtë për të cilën kërkohet mbrojtja e përkohshme e saj. Nuk duhet vërtetuar plotësisht ekzistenca e të drejtës, objekt i shqyrtimit gjyqësor, pasi kjo i përket themelit të padisë, por duhet formuluar një gjykim në lidhje me mundësinë e ekzistencës së saj mbi bazën e një njohje të shpejt dhe të sipërfaqshme (*summaria cognito*) të çështjes, arsye për të cilën padia duhet të mbështetet në prova me shkresë<sup>2</sup>, në përputhje me parashikimet e Neni 202 (a) të KPC-së.

Lidhur me këtë Kolegjet e Bashkuara të gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 10, datë 24.03.2004 shprehen se: “Gjykatat, vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtu shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmange çdo lloj perceptimi sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim

Ndërsa kushti i dytë, (*Periculum in mora*) ka të bëjë me ekzistencën e arsyeve të cilat bëjnë të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Pra behet fjalë për një dëm që mund t’i shkaktohet të drejtave të paditësit. Vlen të theksohet se kemi të bëjmë me një dyshim të bazuar në arsye dhe jo me një bindje të plotë e të bazuara në fakte të vërtetuara, siç është bindja që krijohet tek gjyqtari pasi është shqyrtuar në themel çështja.<sup>3</sup>

Neni 202 (a) i K.P.C-së, kërkon gjithashtu paraqitjen e provave shkresore nga ana e Paditësit, kusht pa të cilin nuk do të mund të lejohet marrja e masës së sigurimit të padisë. Ky kusht, shërben për të vlerësuar nëse përmbushen dy kushtet e sipërpërmendura të masës së sigurisë: *fumus boni juris* dhe *periculum in mora*. Gjithashtu edhe në praktikën gjyqësore shqiptare reflektohet rëndësia e paraqitjes së provave shkresore në gjykimin e kërkesës për sigurim padie. Në një vendim të saj, Gjykata e Lartë shprehet se: “për vendosjen e masës së sigurimit të padisë sipas germës a) të nenit 202 të K.P.C., gjykata duhet të ketë parasysh që të plotësohen dy kushte njëherësh, të cilët janë: pala kërkuese të ketë paraqitur prova shkresore dhe të ketë dyshime se ekzekutimi i vendimit bëhet i pamundur, ose i vështirë, por gjykata nuk ka asnjë të drejtë që të bëjë vlerësimin e provave shkresore të paraqitura nga kërkuesi, sepse kjo do ta

<sup>1</sup> Procedurë Civile, Dr. Flutura Kola-Tafaj, Asim Vokshi LLM, Fakulteti i Drejtësisë UT,2011, faqe 164.

<sup>2</sup> Neni 202 (a) KPC.

<sup>3</sup> Procedurë Civile, Dr. Flutura Kola-Tafaj, Asim Vokshi LLM, Fakulteti i Drejtësisë, UT,2011, faqe 165.

*çonte atë në paragjykimin e zgjidhjes së çështjes në themel, duke cenuar parimin e rëndësishëm të zhvillimit të rregullt të një procesi gjyqësor, të parashikuar nga neni 4 i K.P.C.<sup>4</sup>*

Gërma b) e nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile parashikon gjithashtu se: *“paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t’i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.”* Ligjëvënësi ka parashikuar një kusht tjetër për lejimin e vendosjes së masës së sigurimit të padisë, që është dhënia e një garancie nga ana e paditësit për zhdëmtimin e dëmeve eventuale që mund t’i shkaktohen të paditurit. Kërkimi i garancisë është lënë në diskrecionin e gjykatës e cila cakton masën, llojin e saj si dhe afatin brënda të cilës garancia duhet të jepet.<sup>5</sup> Përsa i përket praktikës gjyqësore lidhur me interpretimin e gërmeve a) dhe b) të nenit 202 të KPC-së sjellim në vemëndje Vendimin e Gjykatës së Lartë Nr. 227 datë 08.05.2012 e cila shprehet se: *“Nga citimi i dispozitës ligjore të mësipërme del e qartë se sigurimi i padisë bëhet në dy raste; kur ka prova me shkrësë dhe kur jepet garanci bankare....në rastin kur ka prova me shkrësë nuk është e detyrueshme që të vendoset garancia bankare, por është në vlerësim të gjykatës nëse duhet vendosur ose jo kjo garanci”.*

### III. PROCEDURA E ANKIMIT E MASËS SË SIGURIMIT TË PADISË

Procedura e ankimit të masës së sigurimit të padisë, rregullohet nga nenet 209 dhe 210 të KPC-së. Neni 209, parashikon se: *“Kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë, mund të bëhet ankim i veçantë. Ankimi i vendimit të sipërm nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të padisë.”*

Kodi shprehet shumë qartë kur specifikon se vetëm vendimet të cilat pranojnë, ndryshojnë, ose heqin masën e sigurit të padisë, mund të ankimohen nëpërmjet ankimit të veçantë. Në këtë dispozitë, nuk ka një përcaktim të shprehur lidhur me ankimin kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për sigurimin e padisë, pra nëse do të lejohet ankim i veçantë kundër këtij vendimi. Duhet kujtuar se vendimi për masën e sigurimit të padisë, në përputhje me përkufizimin e nenit 125 të KPC-së, është një vendim i ndërmjetëm. Si i tillë rregullohet edhe nga neni 470 të KPC-së, i cili përcakton rregullat e dhe procedurat e ankimit kundërvendimeve të ndërmjetme: *“Vendimet e ndërmjetme që jepen nga gjykata e shkallës së parë mund të ndryshohen apo të tërhiqen gjatë gjykimit. Këto vendime mund të goditen me ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Megjithatë, në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë Kod, kundër vendimeve të ndërmjetme mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja apo njoftimi i tyre.”*

Pra si pasojë, duke mos u parashikuar shprehimisht në ligj e drejta e palëve për një ankim të veçantë, vendimi i ndërmjetëm i cili rrëzon kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë mund të ankimohet vetëm në momentin e ankimit kundër vendimit përfundimtar. Praktikisht Gjykata në prani të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të padisë, mund të vendosë:

- i. të shprehet me vendim duke e pranuar masën e sigurimit të padisë, dhe në këtë rast palës ndaj të cilës është vendosur masa e sigurimit të padisë i lind e drejta për të bërë ankim të veçantë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit;

<sup>4</sup> Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr. 227, Datë 08.05.2012,.

<sup>5</sup> Procedura Civile, Alban Abaz Brati, Botimet Dudaj, 2008, faqe 196.

- ii. të shprehet me vendim i cili refuzon kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Në këtë rast, kërkesit nuk i lind e drejta për ankim të veçantë me afat 5 ditor, por i jepet vetëm mundësia të godasë këtë vendim të ndërmjetëm së bashku me atë të themelit, pavarësisht pretendimeve të tij të *Periculum in mora* dhe *Fumus boni juris* që janë thelbi i institutit të masës së sigurimit të padisë.

Pra kemi nenin 209 të KPC-së i cili nuk parashikon ankim të veçantë lidhur me vendimet e refuzimit të kërkesave për masën e sigurimit të padisë, dhe nenin 470 të KPC-së i cili parashikon të drejtën e ankimit kundër këtij vendimi por duke e shtyrë atë në momentin e ankimit të vendimit përfundimtar. Në praktikën e gjykatave të shkallës së parë, në disa raste gjykatat e kanë njohur të drejtën e ankimit të veçantë në dispozitivin e vendimit të rrëzimit të kërkesës për masë sigurimi dhe në të tjera raste janë shprehur se ndaj atij vendimi nuk lejohet ankimi i veçantë.<sup>6</sup> Gjithashtu pranë Gjykatës së Apelit Tiranë kemi qëndrime të kundërta lidhur me të drejtën e ankimit, ashtu si mund të vihet re nga vendimi nr. 27 datë 25.02.2013 ku Gjykata shprehet se: “*Siç shihet nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme, por dhe në kuptim të nenit 125 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi objekt gjykimi futet në ato vendime të ndërmjetme për të cilat është parashikuar ankim i veçantë, i cili në kuptim të nenit 443 ky afat është 5 ditor.*” dhe në vendim nr. 123 datë 03.04.2013 shprehet se: “*Në lidhje me ankimin e paraqitur nga ankuesi, pa i hyrë shkaqeve të pretenduara në këtë ankim, nga Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit Tiranë konstatohet, se ankimi i depozituar në kryesekretarinë e gjykatës së shkallës së parë, është paraqitur ndaj një vendimi, që sipas parashikimeve në ligj, nenit 209 të K.Pr.Civile, nuk lejohet ankim*”.<sup>7</sup>

Ky fakt është vënë në dukje edhe nga Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë, i cili është Shprehur se: “...*.....kundër vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që nuk ka pranuar, pra ka rrëzuar kërkesën për sigurimin e padisë, Kodi nuk ka parashikuar shprehimisht se ndaj tij mund të bëhet ankim i veçantë, por mund të goditet vetëm me ankim së bashku me vendimin përfundimtar.*”<sup>8</sup> Një fenomen i ngjashëm është hasur edhe në Itali, ku deri para vitit 1995 neni 669-terdecies i KPCI nuk lejonte ankimin e veçantë ndaj vendimeve të cilat refuzonin dhënien e masave të sigurimit. Më pas ky nen u konsiderua antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese Italiane, e cila arsyetoi se ‘*mbështetur në parimin e barazisë së plotë të palëve dhe barazisë së armëve gjatë procesit civil, mungesa e ankimit kundër vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurim padie, për palën që ka kërkuar një masë sigurimi përbën një shkelje të së drejtës për t’u mbrojtur, duke favorizuar palën që është kundra masës së sigurimit. Kjo situatë tregon haptazi një pozitë jo të barabartë të palëve gjatë procesit civil. Vendimi për pranimin apo rrëzimin e masave të sigurimit, cenon interesat e njërës palë apo tjetrës, ndaj nuk është e arsyeshme që vendimi i rrëzimit të konsiderohet apriori më i bazuar se vendimi i pranimit. Lejimi i ankimit vetëm për vendimin e pranimit krijon pabarazi*’<sup>9</sup>.

Por përveç rastit krahasues të shteti italian shembulli më i vlefshëm lidhur me trajtimin e masave të sigurimit të padisë e hasim në një nga procedurat gjyqësore Shqiptare, atë administrative.

Në vitin 2012 hyri në fuqi Ligji nr. 49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.*” “*Synimi i kësaj nisme ligjore ishte*

<sup>6</sup> Masat e sigurimit të padisë në proceset gjyqësore dhe të arbitrazhit, Silvana Çinari, Fakulteti i Drejtësisë, UT, 2015, faqe 60.

<sup>7</sup> Masat e sigurimit të padisë në proceset gjyqësore dhe të arbitrazhit, Silvana Çinari, Fakulteti i Drejtësisë, UT, 2015, faqe 61.

<sup>8</sup> Vendim Nr. 445 datë 17.04.2007, Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

<sup>9</sup> Vendim Nr. 253 datë 23.06.1994, Gjykata Kushtetuese Italiane.



*reformimi i procedurave gjyqësore të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve administrative në drejtim të shpejtësisë dhe cilësisë përmes ngritjes së një sistemi gjyqësor autonom të specializuar me gjyqtarë administrativë”<sup>10</sup>.*

Ajo që vlen të përmendet në kontekstin e kësaj analize ligjore është trajtimi i masave të sigurimit të padisë në procesin gjyqësor administrativ. Neni 32 pika 1 i Ligjit 49/2012 parashikon se: “*Kundër vendimit të gjykatës për pranimin apo refuzimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për heqjen, ndryshimin ose zëvendësimin e vendimit për sigurimin e padisë, mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën më të lartë*”. Pra përsa i përket procedurave pranë gjykatës administrative gjendemi në kushte të plota barazie të mjeteve ligjore në lidhje me ankimin e vendimit për masën e sigurimit të padisë, pasi ligjvënësi në këtë rast, ndryshe nga sa ka parashikuar në KPC, përcakton të njëjtën procedurë ankimi, pra ankimin e veçantë, në rast pranimit, refuzimit, heqje, ndryshim si dhe zëvendësim të vendimit për masën e sigurimit të padisë.

#### IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Shpjeguar në hyrje të këtij shkrimi se kërkesa për masën e sigurimit të padisë mbështetet në argumentimin se ekzekutimi i vendimit për të drejtën e cenuar mund të bëhet i pamundur ose i vështirë, pra synim thelbësor i masave të sigurimit është mos dëmtimin i objektit të gjykimit, deri në përfundimin e tij.

Mosparashikimi i ankimit të veçantë të vendimeve të cilat refuzojnë kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë cenon rëndë vetë thelbin e masës së sigurimit të padisë. Gjithashtu krijon një pabarazi të mjeteve ligjore në dispozicion të palëve pasi neni 209 parashikon ankimin e veçantë në rastin e pranimit, ndryshimit ose heqjen e masës dhe jo në rastin e refuzimit të saj, duke krijuar kështu një shkelje të së drejtës për t’u mbrojtur dhe mbi të gjitha një shkelje të rëndë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Ajo që vlen të theksohet është se vetë karakteristika e masës së sigurimit të padisë është urgjenca dhe domosdoshmëria për të ngrirë gjendjen deri sa të vërtetohet e drejta nëpërmjet vendimit të themelit. Në rastin e refuzimit të kërkesës për masën e sigurimit të padisë kjo urgjencë dhe domosdoshmëri nuk gjen mbrojtje të barabartë ligjore me pasojë mundësinë e cenimit të pariparueshëm të ekzekutimit të vendimit përfundimtar.

Llogjika e cila ka shtyrë ligjvënësin të krijojë këtë pabarazi të mjeteve ligjore të cilat synojnë mbrojtjen e të drejtave pranë gjykatave shqiptare është e paqartë dhe antikushtetuese. Për shmangien e vazhdimin të mohimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor është e domosdoshme të ndryshohet neni 209 duke përfshirë vendimin e refuzimit në ankimet e veçanta duke e riformuluar atë si vijon “*Kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin ose refuzimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë, mund të bëhet ankimi i veçantë. Ankimi i vendimit të sipërm nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të padisë.*”

<sup>10</sup> Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, 2015, faqe 52.